

KOMENTET E OPERATOREVE DHE QENDRIMI I AKEP MBI

DOKUMENTIN PËR KËSHILLIM PUBLIK

Për

“Performancën e bazës së të dhënave referencë të centralizuar për Portabilitetin e Numrit (CRDB)”

AKEP bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, bazuar në pikën 5 të nenit 10 të Rregullores nr. 13 “Për portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar, kreu keshillimn publik. Komentet e operatoreve dhe qendrimi i AKEP jepen ne vijim:

- 1. AKEP bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, ligji nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar Rregulloren nr. 13 “Për portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar, kryen kete keshillim publik me palet e interesuara në lidhje me funksionimin e CRDB, me qëllim marrjen e të gjitha opinionëve të mundshme nga palët e interesuara. Bashkengjitur jane raportet e gjeneruara nga sistemi.**

AKEP kerkon vleresimin dhe argumentat tuaja lidhur me këtë çështje?

Operatori A:

(Koment per procesin, jo CRDB). Mire do ishte qe ti kishim edhe raportet, por opinion i Operatori A kundrejt operatoreve te tjere eshte qe procesi i tyre vazhdon te mbetet gjysem-manual. Argument mund te merren rastet me te fundit te 1 Tetorit (fondacioni Besa) ku ne te njejten kerkese portin (e njejta fature) 4 linja pranohen, kurse 11 te tjerat behen reject per ‘Moslikuidim fature’.

Komenti AKEP:

Kjo ceshtje eshte jashte objektit te ketij konsultimi publik, i cili ka si objekt funksionimin e CRDB.

Operatori B:

Ne lidhje me konsultimin publik mbi “Performancën e bazës së të dhënave referencë të centralizuara për Portabilitetin e Numrit” sic edhe e kemi konfirmuar me heret nepermjet takimeve bashkepunuese me palen tuaj dhe pas feedback-ut te marre nga skuadrat operacionale brenda kompanise, Operatori B ka pasur nje eksperience te kenaqshme deri me tani ne lidhje me procesin e portabilitetit; njekohesisht nuk jemi perballur me ceshtje deri me tani, qe konfliktojne me veprimet e perditshme operacionale apo per te cilat gjykojme te kete nevoje per ndryshime te sugjeruara nga ana jone.

Operatori B shpreh dhe njehere konsideraten per mbeshtetjen dhe transparencen e ofruar nga AKEP dhe pala juaj ne proces

Komenti AKEP:

Operatori Operatori B ndan te njejtin mendim me AKEP per kete ceshtje.

- 2. Pyetje: A keni koment lidhur me funksionimin dhe teknologjinë e përdorur? Në se mendoni se funksionimi duhet ndryshuar ose zgjeruar ju lutemi argumentat tuaj.**

Operatori A:

Teknologjia eshte e avancuar dhe mbeshtet me se miri nevojat tona. Duke patur parasysh qe komunikimi Telekom-CRDB eshte FULL Automatic, "response time" ne 100% te rasteve ka gene korrekt.

Komenti AKEP:

Operatori ndan te njejtin mendim me AKEP per kete ceshtje.

- 3. AKEP, kerkon vleresimin tuaj mbi nivelin e bashkëpunimit midis AKEP, ofruesit të CRDB dhe operatorëve që përdorin këtë sistem. Argumentat tuaja lidhur me këtë çështje duke i bashkëngjitur dhe rastet kur keni komunikuar me AKEP apo me ofruesin e CRDB?**

Operatori A:

Niveli i bashkëpunimit eshte i pranueshem. 2-3 raste qe jane raportuar si problematike e CRDB kane marre pergjigje brenda 24 oreve.

Komenti AKEP:

Operatori ndan te njejtin mendim me AKEP per kete ceshtje.

- 4. AKEP, kerkon vleresimin tuaj ne se shërbimi që ofrohet nga CRDB është gjithë përfshirës. Argumentat tuaja lidhur me këtë çështje dhe nëse keni propozime të tjera?**

Operatori A:

Asnje problematike per tu raportuar. Eshte gjithë perfshires, duke nenkuptuar qe si proceset Mobile-Mobile, ashtu edhe ato Fiks-Fiks funksionojne normalisht.

Komenti AKEP:

Operatori ndan te njejtin mendim me AKEP per kete ceshtje.

- 5. AKEP bazuar në Rregulloren nr.13 “Për Portabilitetin e Numrit” e ndryshuar, kërkon të evidentojë nëse ka persona të tjerë juridik, të interesuar për të qënë ofrues të bazës së të dhënave reference të centralizuar.**

Operatori A:

Jo kompetence e operatorit. Megjithatë nuk kemi ndonjë oferte në kompani. Nëse kërkohej nga ana jone të evidentojmë persona juridike për të qënë ofrues të databasës, na bëni me dije.

Komenti AKEP:

Nga keshillimi publik nuk ka patur sipërmarres në fushë të teknologjisë së informacionit që kanë shprehur interes për të qënë ofrues të bazës së të dhënave reference të centralizuar. AKEP vlerëson gadishmerinë e operatoreve për të dhënë evidencë për këtë pikë.

- 6. Argumentat nëse keni ndonjë çështje tjetër për t’u marrë në konsideratë.**

Operatori A:

AKEP duhet të garantojë procesin automatik të portimit nga të gjithë operatorët, të cilët janë detyrueshëm për të gjithë operatorët në bazë të rregullores së NP nga AKEP.

Komenti AKEP:

AKEP bëni me dije se kjo çështje është e mirë përcaktuar në nenin nr.15 të rregullores “Përgjigja për Bartje”, pikë 3.